



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira-Department Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr. 37/2021

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, znj. Diellza Hoxha dhe znj. Myjesere Mujku, anëtare të Komisionit Disiplinor, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat z. _____, si organ përmbarues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në _____, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, dhe pas seancës këshillimore dhe votimit, me datën 11.11.2021, mori si në vijim:

V E N D I M

KONSTATOHEN të tërhequra Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-37/2021, datë 05.10.2021 si dhe Propozimi për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat z. _____ i datës 21.09.2021, i paraqitur nga z. _____ i Odës së Përmbaruesve Privat të Kosovës.

A r s y e t i m

Me datën 21.09.2021, z. _____ i Odës së Përmbaruesve Privat të Kosovës ka paraqitur Propozimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat z. _____ si organ përmbarues i emëruar për Territorin e Gjykatës Themelore në _____, pasi që i njëjti nuk i ka përmbushur të gjitha detyrimet për anëtarësi ndaj Odës së Përmbaruesve Privat të Kosovës për vitin 2020. Sipas propozimit, administrata e Odës disa herë ka dërguar kërkesa përmes adresës elektronike tek përmbaruesi privat, ai është kontaktuar edhe përmes telefonit si dhe janë shfrytëzuar kuvendet ose trajnimet për t'ia rikujtuar obligimin për të përmbushur detyrimet në pajtim me vendimin e Kuvendit të Odës së Përmbaruesve të Kosovës të dt 04.03.2021, por i njëjti

ka paguar një pjesë të detyrimeve ndërsa pjesën tjetër të detyrimit edhe pse ka premtuar nuk e ka përmbushur.

Me datën 05.10.2021, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat, ka paraqitur në Komision Raportin Përfundimtar ndaj përmbartuesit privat z. _____, si organ përmbartues i emëruar për Territorin e Gjykatës Themelore në _____.

Përmbartuesi privat z. _____ në përgjigjen e tij me shkrim me dt 20.10.2021 ka njoftuar Komisionin se ka përmbushur detyrimin e tij si dhe ka bashkangjitur provat se detyrimi është përmbushur me dt 27.09.2020 përkatësisht me dt 12.10.2021.

Me datën 05.11.2021, Komisioni Disiplinor ka pranuar Kërkesën nr.08-1775 nga kryetari i Odës së Përmbartuesve Privat të Kosovës. Sipas kërkesës, pasi që përmbartuesit privat z. _____ ka përmbushur detyrimet e tij lidhur me pagesat e kontributeve, parashtuesi konform nenit 366 dhe 367 par 1.11, të Ligjit për Procedurën Përmbartimore tërhiqet nga propozimi për fillimin e procedurës disiplinore.

Me datën 11.11.2021, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, ndërsa përmbartuesi privat, z. _____ dhe përfaqësuesi i Odës së Përmbartuesve Privat të Kosovës edhe pse ishin të njoftuar nuk kanë prezantuar.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat, znj. Fadilete Hoxha ka theksuar se pasi që paraqitësi i propozimit për fillimin e procedurës disiplinore ka njoftuar Komisionin Disiplinor se përmbartuesi privat z. _____ ka përmbushur detyrimet e tij dhe tërheqin propozimin, atëherë, edhe Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat tërhiqet nga Raporti përfundimtar DPL. Nr 37/21, dt 05.10.2021, i paraqitur në Komision Disiplinor.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARTUESIT PRIVAT
DPL.nr 37/2021, datë 11.11.2021**

**Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUFI**



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.